



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2019:143837
Datë: 24.02.2021
Numri i dokumentit: 01538412

C.nr. 100/16

GJYKATA THEMELORE GJILAN/DEGA NË VITI - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Arben Xheladini, në çështjen kontestimore të paditësit, Korporata Energjetike e Kosovës sh.a, (KEK) me seli në Prishtinë, Sheshi “Nëna Terezë” nr, 36, e përfaqësuar nga Fahri Fazliu, jurist nga Prishtina, kundër të paditurit N.N nga fshati Gjylekar, Komuna e Vitisë, me objekt kontesti kompensimi i dëmit, vlera e kontestit 270.88 Euro Euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 15.20.2021, jashtë seance, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I.** Refuzohet kërkesëpadia e paditëses Korporata Energjetike e Kosovës sh.a. (KEK) me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që i padituri N.N, të detyrohet t’ia kompensoj dëmin e shkaktuar material në shumë prej 270.88 Euro, me kamatë ligjore, prej datës së shkaktimit të dëmit e deri në pagesën definitive.
- II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja Korporata Energjetike e Kosovës sh.a., (KEK), në padinë e datës 18.03.2016, dhe gjatë shqyrtimit kryesor, nëpërmejt përfaqësuesit të saj me autorizim, ka kërkuar nga Gjykata, t’ia aprovojë kërkesëpadinë, dhe ta detyroj të paditurin për kompensimin e dëmit të shkaktuar material në shumë prej 270, 88 Euro, duke theksuar se i padituri, me aktgjykimin P.nr.261/10, i datës 25.01.2012, ishte gjetur fajtor për vepër penale të vjedhjes. Në fjalen përfundimtare, kamatën e ka kërkuar nga data e shkaktimit të dëmit, ndërsa shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

I padituri, në përgjigje padi e ka kontestuar kërkesën e paditëses duke theksuar se është e parashkruar dhe ka kërkuar nga gjykata që ta refuzoj si të pa bazuar.

Me datë 15.02.2021, shqyrtimi kryesor i çështjes, është mbajtur në mungesë të të paditurit, pasi që nga shkresat e lëndës është konstatuar se i padituri, thirrjen për shqyrtim kryesor e ka pranuar me rregull, ka munguar dhe mungesën nuk e ka arsyetuar (neni 423.4 i LPK).

Me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, gjykata i ka administruar dhe vlerësuar këto prova: Aktgjykimi P.nr. 261/10, i datës 25.01.2012, i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti dhe Transaksioni i konsumatorit DGL 9027409 në emër të N.N.

Pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, në bazë të nenit 8 të LPK-ës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është e parashkruar, të cilën edhe e refuzoi si të pa bazuar.

Me administrimin e provave materiale gjykata e vërtetoi këtë gjendje faktike: Me Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, P.nr 261/10, i datës 25.01.2012, i padituri N.N ishte shpallur fajtor për veprë penale vjedhje nga nenin 252, par. 1 të Kodit Penal, ndërsa e dëmtuara KEK për realizimin e kërkesës pasurore juridike ishte udhëzuar në kontest civil. Aktgjykimi ishte bërë i plotfuqishëm me datë 06.03.2012 ndërsa, me datë 18.03.2012 paditësja kishte paraqitur padi në gjykatë, me të cilën, ka kërkuar kompensimin e dëmit material.

Meqenëse pretendimi i të paditurit ka qenë parashkrimi i kërkesës, gjykata fillimisht e shqyrtoi këtë pretendim, dhe si ligj material e ka zbatuar Ligjin e Marrëdhënieve të Detyrimeve të vitit 1978 (të cilit, tani e tutje, do t'i referohet me shkurtesen LMD), për shkak se raporti juridik ka ndodhur në kohën kur ky ligj ka qenë në fuqi. Ndërsa, duke qenë se kërkesa e paditëses është mbështetur në aktgjykim penal, si ligj material, sa i përket dispozitave ligjore të llogaritjes së afateve të parashkrimit të ndjekjes penale, gjykata e zbatoi Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës – Rregulloren e UNMIK-ut 2003/25 (të cilit, tani e tutje do t'i referohet me shkurtesën KPPK), i cili ka qenë në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale nga i padituri dhe është zbatuar kundër tij.

Me nenin 376.1 të LMD është përcaktuar: “Kërkesa e shpërblimit të dëmit të shkaktuar parashkruhet për tre vjet nga data kur i dëmtuari ka mësuar për dëmin dhe për personin që e ka bërë dëmin”. Ndërsa, për rastet e shkaktimit të dëmit me veprë penale, LMD në nenin 377 ka përcaktuar: “Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashikuar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa për shpërblim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”.

Me Aktgjykimin penal P.nr. 261/10, i datës 25.01.2012, gjykata vërtetoi se i padituri N.N ishte shpallur fajtor për veprë penale vjedhje nga neni 252, par 1 të KPPK, të cilit ia kishte shqiptuar dënimin përkatës dhe, paditësja, për realizimin e kërkesës pasurore, ishte udhëzuar në kontesti civil. Vepra penale nga neni 252, par 1 të KPPK është e dënueshme me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

Gjykata konstaton se afati i parashkrimit të ndjekjes penale për veprën penale nga neni 252, par. 1 të KPPK është dy vjet për shkak se sanksioni penal për këtë veprë penale është alternativ: denim me gjobë ose me burgim deri në tri vjet.

Ky konstatim i gjykatës bazohet në nenin 90 të KPPK, me të cilin janë përcaktuar afatet e parashkrimit të ndjekjes penale, e që në paragrafin 1 është paraparë: “Me përjashtim të rasteve

kur është paraparë ndryshe me këtë Kod, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse nuk kanë kaluar afatet e mëposhtme [...] nënpar. 6 “Dy vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se një vit burgim ose dënim me gjobë”. Neni 91 i KPPK e përcakton fillimin dhe ndërprerjen e afateve të parashkrimit të ndjekjes penale, i cili në nenin 91.6 shprehimisht ka paraparë: “Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale)”.

Meqenëse aktgjykimi penal është bërë i plotfuqisdhëm me datë 06.03.2012, paditësja, nga kjo datë e ka fituar bazën ligjore për fillimin e procedurës kontestimore për realizimin e kërkesës për kompensim të dëmit të shkaktuar me vepër penale, ndërsa padinë në gjykatë e ka me datë 18.03.2016, pas kalimit të afatit prej katër viteve.

Nga data 07.03.2012, ka filluar të rrjedhë afati i parashkrimit të kërkesës së paditëses, ashtu siç edhe është përcaktuar në nenin 361.1 të LMD: “Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashkikuar diçka tjetër”, ndërsa dita e fundit e parashkrimit ka qenë data 06.03.2016, që në nenin 362 të LMD njihet si lindja e parashkrimit: “Parashkrimi lind kur të ketë skaduar dita e fundit e kohës së caktuar me ligj”.

Pretendimi i paditëses se të rastet e shkaktimit të dëmit me vepër penale-ekzistimit të aktgjykimit penal, afati i parashkrimit dyfishohet nuk qëndron sepse, sipas neni 377 të LMD, te rastet e shkaktimit të dëmit me vepër penale, kërkesa për shpërbllim të dëmit ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale, dhe kjo është paraparë kur afati i parashkrimit të ndjekjes se veprës penale është më i gjatë se afati i parashkrimit të kërkesës. Sipas kësaj dispozite, afati i parashkrimit të kërkesës ndryshon prej rasti në rast sepse, afatet e parashkrimit të ndjekjes penale përcaktohen me kodin penal, ndërsa, kohëzgjatja e afateve varet nga lloji dhe lartësia e dënimit të parashkruar për vepër penale, kryerja e të cilës vërtetohet me aktgjykim të plotfuqisdhëm.

Është e qartë se, qëllimi i kësaj dispozite ligjore ka qenë që, palës së dëmtuar nga vepra penale, t’i mundësohet që në një afat më të gjatë të ketë mundësi të kërkojë dëmin e shkaktuar. Mirëpo, siç u vërtetua, afati i parashkrimit të ndjekjes penale për vepren penale, për të cilën, i padituri ishte dënuar me aktgjykim të plotfuqisdhëm, është katër vjet, e që në raport me afatin tre vjeçar të përcaktuar me nenin 376.1 të LMD, është afat më i gjatë, andaj edhe duhet zbatuar në këtë rast.

Për këtë arsye, gjykata e refuzoi kërkesën e paditëses si të pa bazuar, për shkak se në datën e paraqitjes së padisë në gjykatë, kërkesa ka qenë e parashkruar. Bazuar në neni 360 të LMD, “Me parashkrimin pushon e drejta e kërimit të përmbushjes së detyrimit. Parashkrimi lind kur të ketë kaluar afati i caktuar me ligj brenda të cilit kreditori ka mundur të kërkojë përmbushjen e detyrimit”. Paditësja ka mundur që me padi në gjykatë, të kërkojë kompensimin e dëmit që nga data 06.03.2012 ndërsa, dita e fundit për ta bërë këtë, ka qenë data 06.03.2016.

Provat tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, nuk u elaboruan për shkak se ishin pa ndikim në vendosjen ndryshe të kësaj çështje kontestimore.

Lidhur me shpenzimet e procedurës u vendos sipas neni 451 i LPK pasi që paditësja e humbi kontestin.

Nga të lartcekurat, e duke u bazuar në nenin 2 lidhur me nenin 142 pika 1 dhe 2 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI
C.nr.100/16, datë 15.02.2021

Gjyqtari,

Arben Xheladini

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa në Gjykatën Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afatin prej 7 ditëve, i llogaritur pas ditës së pranimit të aktgjykimit, vetëm për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave mbi procedurën kontestimore dhe për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale (neni 491 i LPK). Ankesa, në kopje të mjaftueshme, dorëzohet përmes kësaj gjykate.